



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Raporti mujor, Korrik 2022

PROJEKTET

- Përpunimi i fileve nga INS-i i mbishtresimeve dhe xhepave;
- Përpunimi i rrugëve me projekt kryesor: Unaza e brendshme, rruga “A”, “B”, “C” dhe rrjetit rrugor rural të ekzekutuar sipas projekteve kryesore;
- Përgatitja e materialit për takimet me qytetarë: Arbëria 1,2,3 dhe Shkabaj, Hajvali, Muhaxhir dhe Aktash, Barilevë;
- Përgatitja e hartës për lagjen “Kodra e Trimave”, si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë;
- Përgatitja e hartës për lagjen “Kolovica”, si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë;
- Përgatitja e hartës për lagjen “Te Hani i Dilit”, si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë, si rrjedhojë e kërkesës së qytetarëve;
- Digjitalizimi i pronave komunale për Drejtorinë e Pronës;
- Përpunimi i hartës për Institucionin e Policisë;
- Përpunimi i draftit të pjesës tekstuale të PZHK-së, komentet e dyta nga MMPH-ja.
- Finalizimi i projektit dhe paramasës për shenjëzimin e hapësirave të komunës me pllaka taktile;
- Projekti për adaptimin e sporteleve dhe laurës (rampës) ekzistuese për personat me nevoja te veçanta;
- Përgatitja e hartës për lagjen “Kodra e Trimave”, si pjesë e dokumentacionit për tenderimin e studimit të fizibilitetit për atë zonë;
- Modifikimi i paramasës dhe planeve të inventarit të kontratës kornizë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale;

- Ne bashkëpunim me DIKMK, grumbullimi i të dhënave për hartimin e detyrës projektuese për IP në lagjen “Mati”, shkollën në Hajvali, Strehimoren për komunitetin LGBTI+ dhe QPS;
- Përfundimi i lëndëve të ndara në kuadër të drejtorisë, “Informime nga planet”, Informime për parcela ndaj kërkesave, kryesisht nga Drejtoria e Pronës;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve, në ditët e caktuara me palë;
- Caktimi i lokacionit për Odën e Mjekëve, në lagjen “Prishtina e Re-Zona Qendër”;
- Takime të rregullta me Drejtoritë e tjera lidhur me koordinimin e aktiviteteve të ndryshme në të cilat Sektori i planifikimit ka dhënë kontribut nga fusha e planifikimit;
- Takime me përfaqësuesit e Bankës Botërore, lidhur me projektet në lagjet: “Kodra e Trimave”, “Kalabria”;
- Caktimi dhe përpunimi i materialit për lokacionet e institucioneve parashkollore në lagjet: “Kolovica e Re”, “Kolovica e Vjetër”, “Mati 1”;
- Caktimi i lokacionit të përkohshëm për tregun e lëndëve djegëse;
- Takim informues rreth studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit për Zonën Historike të Prishtinës, ndërmjet UN Habitat, MRKS dhe OJQ-ve.

- **VIZITAT NË TERREN:**

- Në bashkëpunim me DSHP-në, identifikimi i pikave për shitësit ambulante në shesh;
- Identifikimi i punëve të përfunduara në mënyre jo adekuate me kontratën e mobilitetit;
- Vizitë në Arkivin e Qytetit për mundësinë e renovimit të brendshëm të objektit.

- **TAKIMET:**

- Takim koordinues me Sektorin e planifikimit për zonën e kampusit sportiv;
- Takim me Drejtorinë e Sportit për mundësinë e bashkëpunimit me ndonjë organizatë për realizimin e projektit kryesor për sallën e sporteve me dorë;
- Takim me NPB-në lidhur me mundësinë e realizimit të sporteve;
- Takim me DSHP-në për përcaktimin e lokacioneve për shitësit ambulante;
- Takim me Drejtorinë e Kulturës, lidhur me kërkesat e Arkivit të Qytetit për renovimin e objektit;
- Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë, NPB-në, Hortikulturën për renovimin e oborreve në QMF dhe intervenimeve të brendshme në disa pozicione të këtyre objekteve;

- **Takim me Drejtorinë e Arsimit për vizitë në terren dhe mundësinë e vazhdimit të përgatitjes së paramasës për Qendrën e të Moshuarve në Istog;**
- **Takim koordinues me Drejtorinë e Urbanizmit për komentet e PZHK-së, për kufijtë e lagjeve që do të shkojnë në rigjenerim;**
- **Takim pune me nënkryetaren e KK-së për transformim digjital të Komunës;**
- **Takim pune me Drejtorinë e Pronës për digjitalizim të pronave komunale;**
- **Takim me Sektorin e rigjenerimit urban për lokacionet e objekteve publike që do të ndërtohen;**
- **Takim publik me banorët e lagjes Arbëria 1,2,3 dhe Shkabaj në SHFMU “Mehmet Gjevori”;**
- **Takim publik me banorët e lagjes Hajvalia në SHFMU “Shkendija”.**